



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**“PLANI STRATEGJIK 2021 - 2024
PËR KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË”**

Përmbajtja

Parathënie	3
Përmbledhje e shkurtër	4
I. Historiku dhe konteksti	5
II. Qëllimi i strategjisë	7
III. Misioni ligjor i KLP	8
IV. KLP-ja dhe përfituesit e tij në një shoqëri në ndryshim në përshtatje me standardet europiane	8
V. Vizioni, misioni dhe vlerat thelbësore të KLP-së	9
VI. Programet dhe objekti i aktiviteteve të KLP-së	10
VII. Komisionet e përhershme të KLP-së dhe organizimi i administratës	10
VIII... Aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet për t'u realizuar në tre-mujorin e fundit të vitit 2020	13
IX. Plani i veprimit 2021-2024	21
X. Vlerësimi i riskut	27
XI. Raportimi, indikatorët e performancës dhe sistemi i menaxhimit të performancës	28
XII. Indikatorët kyç dhe objektivat e performancës	30
XIII. Kuadri i shpenzimeve afatmesme të KLP-së	32

Parathënie

Plani Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë përcakton objektivat strategjike të Këshillit për këtë periudhë kohore. Objektivat përfshijnë përpjekjet për sigurimin e: (i) pavarësisë; (ii) llogaridhënies; (iii) meritokracisë dhe objektiv jo i drejtpërdrejtë (iv) eficiencën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Instrumentet që ka në dorë Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta si: vlerësimi i performancës në punë i prokurorëve, verifikimi i pasurisë, figurës, integritetit dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për prokuror, si dhe përgjatë gjithë karrierës së prokurorëve, përcaktimi i numrit të kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, trajnimet, procedimet disiplinore, etj., krahas veprimtarisë me aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë siç janë, Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë, etj.

Drejtimitet dhe veprimtaritë kryesore të punës do të realizohen bazuar në organizimin e ri institucional për qeverisjen e sistemit të drejtësisë, duke respektuar dispozitat kushtetuese dhe ligjore, objektivat strategjike sektoriale, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Hartimi i këtij plani është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kryesorë të sistemit të prokurorisë, Ministrin e Drejtësisë, shoqërinë civile, etj., me mbështetjen e posaçme të ofruar nga Misioni EURALIUS. Për përgatitjen e tij janë konsultuar dokumentet strategjike dhe legjislativi në fuqi, me qëllim krijimin e pasqyrës reale dhe planifikimin e drejtë dhe të saktë si garanci për rezultatet e tij pozitive.

Zhvillimi i veprimtarisë së parashikuar në këtë Plan Strategjik për garantimin e objektivave të sipërpërmendura do të bëjë të mundur përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë penale dhe rritjen e besimit të publikut tek sistemi.

Përmbledhje e shkurtër

Plani Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë përmban vizionin, misionin dhe vlerat thelbësore që do të drejtojnë punën e këtij këshilli, për arritjen e një qëllimi të përgjithshëm që është kontributi për forcimin e shtetit ligjor dhe krijimi i një sistemi të pavarur dhe eficient të prokurorisë që të kontribuojë në mënyrë efektive në luftën kundër krimit duke garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe rritjen e besimit të publikut.

Përveç qëllimit të përgjithshëm, plani përmban objektivin specifik si dhe aktivitetet kryesore të punës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë në 5 vitet në vijim, që do të shërbejnë për të garantuar meritokracinë, profesionalizmin, përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e prokurorëve.

Plani përmban pesë programe të cilat trajtojnë çështje si: 1. Administrimi i karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit; 2. Profesionalizmi dhe integriteti të garantuar nëpërmjet vlerësimeve periodike, standardeve etike dhe profesionale, këshillimit dhe monitorimit të trajnimit vazhdues; 3. Përgjegjshmëria e prokurorëve e garantuar përmes sistemit disiplinor; 4. Garantimi i pavarësisë së prokurorëve, si dhe; 5. Kontributi dhe opinionet për ndryshimin e legjislacionit.

Secili prej këtyre programeve detajohet në një plan veprimi kohor me aktivitete konkrete në drejtimet respektive që do të realizohen dhe ndiqen nga komisionet e përhershme dhe administrata pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Gjatë hartimit të këtij plani janë vlerësuar sfidat dhe rreziqet e mundshme, të përgjithshme, të brendshme apo të jashtme, të natyrave të ndryshme që mund të ndikojnë në punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe disa masa lehtësuese për shmangien apo uljen e efektit të dëmshëm të shkaktuar nga këto rreziqe.

Plani përmban edhe indikatorët e performancës, ku përfshihen vlerat referuese dhe mjetet e verifikimit me qëllim zbatimin e tij.

I. Historiku dhe konteksti

Situata para hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese

Para hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe paketës së ligjeve prioritare të Reformës në Drejtësi në vitin 2016, prokuroria ishte e organizuar dhe operonte nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar. Kjo e fundit përbëhej nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorëve dhe Zyrat e Prokurorive që funksiononin në nivel gjykate rrethi apo apeli.

Sipas sistemit të mëparshëm, **Prokurori i Përgjithshëm** emërohej nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Parlamentit me shumicë të thjeshtë (minimalisht 36 deputetë), për një mandat 5-vjeçar. Megjithatë, kjo nuk ishte e mjaftueshme të garantonte mbështetjen e gjerë nga organi legjislativ dhe të garantonte pavarësinë e nevojshme që duhet të karakterizojë një pozicion të tillë.

Këshilli i Prokurorëve kishte vetëm rol këshillimor për Prokurorin e Përgjithshëm, pa ndikim thelbësor për emërimin, transferimin, procedimet disiplinore dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve. Zhvillimi i karrierës së prokurorëve nuk bazohej në kritere të qarta, ndërsa mungonte një kuadër i plotë ligjor për statusin e tyre.

Zyrat e Prokurorisë të vendosura në nivelet përkatëse gjyqësore rrethi ose apeli ushtronin përgjegjësitë e tyre (hetimin dhe ndjekjen penale) në lidhje me ato vepra penale për të cilat Kodi i Procedurës Penale u jepte juridiksion gjykatave përkatëse.

Analiza e Reformës në Drejtësi e miratuar nga Kuvendi në vitin 2015, identifikoi shumë sfida dhe probleme që haste sistemi i prokurorisë në atë periudhë, veçanërisht për shkak të sistemit të centralizuar hierarkik. Shkurtimisht, këto sfida dhe probleme kishin të bënin me :

- Mungesën e procedurave transparente të testimit të bazuar në meritë për emërimin e kandidatëve për prokurorë dhe mungesa e shkaqeve mbi bazën e të cilave mund të bëhej ankimi i rezultateve të vlerësimit.
- Mungesa e procedurave transparente dhe të bazuara në meritë për transferimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve.
- Mungesa e profesionalizmit në radhët e prokurorëve për shkak të mungesës së kritereve specifike të vlerësimit për matjen e aftësive, kompetencave dhe integritetit të prokurorëve.
- Kohëzgjatja e pamjaftueshme e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm për të ndërmarrë dhe garantuar vazhdimësinë e iniciativave të reformave dhe për të parë rezultatet e tyre në praktikë. Parashikimi kushtetues i mundësisë për një mandat tjetër të Prokurorit të Përgjithshëm nuk mund të garantonte pavarësinë nga pushteti politik.
- Mungesa e përkufizimeve të qarta në lidhje me veprimet që përbënin shkelje disiplinore, duke përfshirë veprimet që diskreditonin reputacionin e prokurorit, duke lënë kështu vend për vlerësime të mundshme subjektive dhe abuzive.

- Këshilli i Prokurorëve kishte vetëm rol këshillimor për Prokurorin e Përgjithshëm, pa ndonjë ndikim thelbësor për emërimin, transferimin, procedimet disiplinore si dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve.
- Përbërja dhe roli i Këshillit të Prokurorisë nuk e garantonte pavarësinë e zyrës së prokurorisë nga politika dhe ndërhyrjet e jashtme.

Strategjia e Reformës në Drejtësi e miratuar nga Kuvendi në korrik 2015 solli si rezultat miratimin e ndryshimeve të rëndësishme kushtetuese në korrik 2016 të shoqëruar me një paketë me rreth 40 ligje dhe ndryshime ligjore. Kuadri i ri ligjor ka ri-themeluar mënyrën e qeverisjes së sistemit të prokurorisë duke mundësuar vetë-qeverisjen pjesshme të sistemit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (më tej, KLP) dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Faza e përkohshme: pas ndryshimeve kushtetuese dhe para ngritjes së KLP-së

Pavarësisht ndryshimeve kushtetuese dhe miratimit të ligjeve prioritare të Reformës në Drejtësi në vitin 2016, ngritja e institucioneve të reja të qeverisjes të sistemit të drejtësisë u zvarrit për arsye të ndryshme, ndër të tjera edhe për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë përfundoi (në dhjetor 2017) para ngritjes së KLP-së. Meqenëse Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për Prokurorinë) ishte tashmë në fuqi, Kuvendi vendosi t’ia caktojë, me bazë të përkohshme, funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm një prej prokurorëve që përmbushte kriteret e parashikuara nga ligji.

Deri në ngritjen e KLP-së, Prokurori i Përgjithshëm kishte vetëm kompetenca të kufizuara bazuar në Nenin 160, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), të para ngushtë me dispozitat e Ligjit për Prokurorinë.

Me gjithë kompetencën e kufizuar në lidhje me emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve, Prokurorët e Përgjithshëm në detyrë, nga korriku 2016 deri në dhjetor 2018, kanë nxjerrë urdhra për caktimin në pozicione të përkohshme të prokurorëve, bazuar në Nenin 160, paragrafi 4, të Ligjit për Statusin, pa arsyetim dhe pa shkak për transferimin e prokurorëve nga një zyrë prokurorie në një tjetër. Besohet se pothuaj 1/3 e të gjithë prokurorëve të Republikës janë caktuar përkohësisht në zyra të tjera Prokurorie gjatë kësaj periudhe tranzitore.

Situata pas ngritjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë

KLP-ja u themelua më 19 dhjetor 2018. Ndryshe nga Këshilli i mëparshëm i Prokurorisë që nuk kishte kompetenca vendimmarrjeje, KLP-ja ka të drejtë dhe detyrim ligjor të garantojë pavarësinë, përgjegjshmërinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Shqipëri. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (Ligji i Qeverisjes) dhe Ligji për Prokurorinë parashikojnë një kuadër të plotë ligjor në lidhje me

kompetencat e KLP-së dhe ato të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me sistemin e prokurorisë, prokurorët dhe nëpunësit civilë të prokurorisë.

KLP-ja ushtron kompetencat kryesore si më poshtë: i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, emëron prokurorët në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, emëron, ngre në detyrë dhe vlerëson prokurorët e të gjithë niveleve, vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve, etj.

II. Qëllimi i Strategjisë

Ligji i Qeverisjes, i ndryshuar, parashikon organizimin dhe funksionet e KLP-së. Neni 160 i këtij Ligji parashikon që KLP përbëhet nga katër komisione të përhershme : i. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; ii. Komisioni Disiplinor; iii. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, dhe; iv. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Neni 180 parashikon që KLP, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik që duhet të jetë në harmoni me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe duhet të:

- Përcaktojë misionin dhe vlerat kryesore të shërbimit të prokurorisë;
- Analizojë profilin e shërbimit të prokurorisë;
- Caktojë çështje strategjike;
- Përcaktojë prioritete;
- Përcaktojë monitorimin, kuadrin vlerësues dhe raportues për strategjinë;
- Përcaktojë burimet e nevojshme financiare për funksionimin e KLP-së dhe për zbatimin e planit.

Kjo strategji synon respektimin e këtyre kërkesave.

Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe asistuar nga ekspertët e misionit EURALIUS, ka nisur procesin e hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë, e cila bazohet mbi konkluzionet për zbatimin e Strategjisë aktuale Ndërsektoriale të Drejtësisë 2016-2020. Faza e parë e zbatimit të reformës në drejtësi për periudhën 2016-2020 ka krijuar bazën kushtetuese, ligjore dhe institucionale që sektori i drejtësisë të funksionojë mbi bazën e standardeve evropiane. Faza vijuese që përfshin 5 vitet e ardhshme (2021 deri në 2025) do të synojë konsolidimin e kësaj kornize si dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, strategjia i shërben gjithashtu një qëllimi më të gjerë. Ajo synon t'u komunikojë ***përfituesve të ndryshëm të KLP-së dhe publikut se çfarë është KLP-ja dhe çfarë planifikon ajo të bëjë në katër vitet e ardhshme, si do të masë performancën e saj dhe si do të raportojë për veprimtaritë dhe arritjet në respektim të misionit të saj.***

III. Misioni ligjor i KLP

Neni 149 i Kushtetutës parashikon që, Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 149/a i Kushtetutës specifikon më tej kompetencat e KLP-së, si më poshtë:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
- ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- d) propozon dhe administron buxhetin e tij;
- dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

Dispozita të tjera më të detajuara për kompetencat e këtij institucioni, janë parashikuar në **Ligjin e Qeverisjes**.

IV. KLP-ja dhe përfituesit e tij në një shoqëri në ndryshim, në përshtatje me standardet europiane

Ndërsa Shqipëria modernizohet dhe kolaudon modelin qeverisës të një demokracie liberale, qytetarët janë gjithnjë e më të interesuar për mënyrën e funksionimit të institucioneve publike, Individualisht ose nëpërmjet grupimeve të aktorëve (si p.sh. OJF-të), ata kërkojnë informacion mbi veprimtarinë e institucioneve publike, shprehin mendimet e tyre se si mund të rregullohen punët dhe përpiqen të ndikojnë në mënyrën se si institucionet publike funksionojnë.

Në këtë kuadër, edhe KLP nuk mund të funksionojë në një rreth të mbyllur. Krejt në të kundërtën, Këshilli duhet të jetë i përgatitur, në mentalitet dhe kapacitete, për të ndërvepruar me një numër në rritje të qytetarëve dhe organizatave të cilët e ushtrojnë aktivisht të drejtën e tyre për të dhënë mendime dhe ndikuar mbi mënyrën e funksionimit të sistemit të prokurorisë.

Në këtë strategji, KLP-ja identifikon dhe përcakton përfituesit e saj dhe sqaron propozimet për mënyrën e menaxhimit të marrëdhënieve me ta.

Përfituesit e drejtpërdrejtë të KLP-së janë prokurorët dhe punonjësit e shërbimit të prokurorisë, përfshirë këtu kancelarët.

Përfituesit e tërthortë të shërbimeve të KLP-së janë gjykata, policia gjyqësore, palët në procesin penal, Dhoma e Avokatisë, institucionet që ushtrojnë pushtet ekzekutiv dhe publiku i gjerë.

Partnerët e programit të KLP-së janë Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, institucionet e rivlerësimit, Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Avokatisë, Avokati i Popullit, Ministria e Brendshme, dhe projektet e asistencës teknike në mbështetje të KLP-së si, EURALIUS dhe OPDAT.

Institucionet e tjera shtetërore përfshijnë agjencitë qeveritare që kërkojnë asistencë nga KLP-ja.

Aktorë të tjerë nga shoqëria civile janë organizatat që veprojnë në fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut, media, dhe Shoqata e Prokurorëve, etj.

Pjesë e rëndësishme e punës së KLP-së është kuptimi i roleve dhe interesave për të gjithë këta përfitues dhe për të gjetur mënyra për të ndërvepruar me ta dhe për të garantuar përmbushjen e pritshmërisë legjitime të përfituesve.

Me partnerët e drejtëpërdrejtë, KLP ka komunikim të vazhdueshëm institucional, jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit, lidhur me procese të rëndësishëm verifikimi, gjatë karrierës së secilit prokuror, por edhe asistimi dhe përfshirje në tavolina të përbashkëta, në grupe pune ndërinsticionale, ashtu sikurse në kontribute thelbësore që kushtëzojnë integrimin evropian të Shqipërisë.

Ndërsa, për ta bërë komunikimin me aktorët e tjerë sa më të frytshëm, KLP, në fund të muajit Shtator 2020 ka prezantuar Strategjinë e Komunikimit të KLP. Ky dokument u hartua posaçërisht për zhvillimin dhe përmirësimin e komunikimit me publikut dhe atë institucional dhe ndër institucional.

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për komunikimin me median dhe publikun për gjykatat dhe prokuroritë, hartimi i strategjisë së komunikimit synon rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Për të garantuar një sistem të qëndrueshëm, i cili do të zhvillohet paralelisht me institucionin, dhe një nivel sa më të lartë transparence dhe përgjegjshmërinë në komunikimin me publikun, nevojitet një qasje pro-aktive ndaj komunikimit, ku publiku të informohet për aktivitetet e institucionit, por njëkohësisht të ketë mundësi të komunikojë në mënyre aktive me vetë institucionin.

V. Vizioni, misioni dhe vlerat thelbësore të KLP-së

Në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Qeverisjes, KLP-ja ka adoptuar vizionin, misionin dhe vlerat thelbësore të mëposhtme në veprimtarinë e saj:

Vizioni

Brenda vitit 2030, KLP-ja do të jetë një institucion publik i konsoliduar dhe elitar që drejton dhe zhvillon prokurorë të klasit botëror, duke rritur besimin e publikut dhe përmbushur standardet europiane.

Misioni

KLP-ja garanton statusin e prokurorëve, të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të mirëtrajtuar, të gëzojnë besimin e publikut, duke inkurajuar performancën më të mirë të tyre, për të luftuar krimin e organizuar dhe të zakonshëm, në përputhje me ligjin.

Vlerat Thelbësore

Vlerat thelbësore të KLP-së janë:

1. Objektiviteti;

2. Rritja e besimit në sytë e prokurorëve;
3. Korrektesa dhe saktësia në realizimin e detyrave;
4. Koherenca në vendimmarrje;
5. Standardet më të larta profesionale;
6. Transparenca;
7. Përgjegjshmëria/llogaridhënia.

VI. Programet dhe objekti i aktiviteteve të KLP-së

Në një kuptim më të gjerë, **qëllimi ose objektivi i përgjithshëm** i punës së KLP-së është kontributi për forcimin e shtetit ligjor dhe krijimi i një sistemi të pavarur dhe eficient të prokurorisë që të kontribuojë në mënyrë efektive në luftën kundër krimit duke garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe rritjen e besimit të publikut. Pjesë e këtij qëllimi është ndihma për të lehtësuar procesin e integritetit në BE dhe zhvillimi i gjerë ekonomik dhe social përmes reduktimit të krimit dhe korrupsionit.

Objektivi specifik i punës së KLP-së është garantimi i pavarësisë, meritokracisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve në Shqipëri.

Rezultatet e pritshme të prodhuara nga KLP-ja janë grupuar në pesë programe (si funksione dhënëse të shërbimit) që janë:

Programi 1: Administrimi i karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit.

Programi 2: Profesionalizmi dhe integriteti i garantuar nëpërmjet vlerësimeve periodike, standardeve etike dhe profesionale, këshillimit dhe monitorimit të trajnimit vazhdues.

Programi 3: Përgjegjshmëria e prokurorëve e garantuar përmes sistemit disiplinor.

Programi 4: Garantimi i pavarësisë së prokurorëve.

Programi 5: Kontributi dhe opinionet për ndryshimin e legjislacionit.

Aktivitetet për secilin program dhe zbatimi i tyre nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë katër viteve në vazhdim specifikohen më tej në planin katër-vjeçar të veprimtimit në Kapitullin IX. Ndërsa, në Kapitullin VIII, përveç aktiviteteve të realizuara përgjatë vitit 2020 pasqyrohen veçmas edhe disa aktivitete të tjera që janë në proces realizimi në tre-mujorin e fundit të vitit 2020.

VII. Komisionet e Përherëshme të KLP-së dhe Organizimi i Administratës

Neni 160, i Ligjit të Qeverisjes parashikon se, Komisionet e Përherëshme të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ushtrojnë aktivitetin dhe marrin vendime në fushat e tyre specifike ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit, miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtij të fundit.

Komisionet e Përhershme janë si më poshtë:

- a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit;
- b) Komisioni Disiplinor;
- c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;
- ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Neni 176 parashikon një administratë “që asiston realizimin e misionit dhe funksioneve të Këshillit”. Administrata ‘kryesohet nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë’ dhe anëtarët e personelit kanë statusin e punonjësve të shërbimit publik në përputhje me Ligjin për ‘Nëpunësin civil’.

Neni 177 parashikon pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i cili është funksionari më i lartë administrativ i Këshillit.


Neni 178 parashikon që Këshilli vendos për strukturën e administratës dhe parashikon që, administrata ndahet të paktën, në njësitë e mëposhtme:

- a) Njësia mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike;
- b) njësia mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të Këshillit;
- c) njësia mbështetëse për administrimin e buxhetit të Këshillit;
- ç) zyra e Këshilltarit të Etikës;
- d) Njësia Mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet;
- dh) njësi mbështetëse për teknologjinë e informacionit;
- e) njësia mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë.

Neni 178 paragrafi 2, germa c) parashikon që, Këshilli përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë njësive organizative të administratës dhe pozicioneve individuale.

Më 6 mars 2019, KLP-ja miratoi strukturën organizative për administratën e saj në total prej 65 anëtarë dhe staf administrativ.

Struktura organizative e Këshillit është e organizuar sipas organigramës së mëposhtme.



Nep. autorizues - Vartesia funksionale

përmbajnë aktivitetet kryesore me objektiva konkretë të vendosura në periudha tre-mujore kur janë realizuar apo janë planifikuar të realizohen.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2020

Emërtimi i aktivitetit	Janar-Mars	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Dhjetor
Caktimi i numrit të kandidatëve për prokurorë në SHM, për vitin akademik 2020-2021 ¹	Vendim nr. 1, datë 15.01.2020			
Miratimi i relacioneve mbi verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të 10 kandidatëve për t'u emëruar magjistrat prokuror, pas diplomimit në SHM, në vitin akademik 2018-2019 ²	Vendime nr. 9-18, datë 20.01.2020			
Emërimi si prokurorë dhe caktimi në detyrë të 10 prokurorëve ³	Vendime nr. 38-47, datë 11.02.2020			
Miratimi i aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës për	Vendim nr. 52, datë 11.02.2020			

¹ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-nr-01-15.01.2020.pdf>

² <https://klp.al/2020/01/22/vendime-date-20-01-2020/>

³ <https://klp.al/2020/02/20/vendime-date-11-02-2020/>

periudhën Janar-Mars 2020 ⁴				
Miratimi i kryerjes së verifikimit të pasurisë dhe figurës të magjistratëve, kandidatë për t'u komanduar si inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ⁵	Vendim nr. 55, datë 24.02.2020			
Miratimi i kryerjes së verifikimit të figurës dhe pasurisë për kancelarët në detyrë ⁶	Vendim nr. 56, datë 24.02.2020			
Komandimi i 6 magjistratëve si këshilltarë pranë KLP ⁷	Vendime nr. 66-71, datë 24.02.2020			
Ndryshimi i Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 ⁸	Vendim nr. 78, datë 04.03.2020			
Miratimi i listës me emrat e kandidatëve për prokurorë pranë	Vendim nr. 84, datë 18.03.2020			

⁴ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-nr-52-11.02.2020.pdf>

⁵ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-nr-55-24.02.2020.pdf>

⁶ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-nr-56-24.02.2020.pdf>

⁷ <https://klp.al/2020/02/27/vendime-date-24-02-2020/>

⁸ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/03/vendim-nr-78-04.03.2020.pdf>

Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të cilët plotësojnë kushtet ligjore pas vlerësimit paraprak ⁹				
Miratimi i vendimit “Për krijimin dhe administrimin pranë KLP të dosjes personale dhe regjistrin të prokurorëve” ¹⁰		Vendim nr. 96, datë 15.04.2020		
Miratimi i raportit të veprimtarisë së KLP për periudhën Janar 2019 – Dhjetor 2019 ¹¹		Vendim nr. 98, datë 24.04.2020		
Transferimi i përhershëm i kancelarit në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ¹²		Vendim nr. 111, datë 24.04.2020		
Miratimi i listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe		Vendim nr. 125, datë 19.05.2020		

⁹ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/03/vendimi-nr.84.pdf>

¹⁰ https://klp.al/ep-content/uploads/2020/04/vendim.nr_.96_15.04.2020_compressed.pdf

¹¹ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-2.pdf>

¹² <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/05/vendimet-dt-24dt-30-pages-15-16-compressed.pdf>

Krimet të Organizuar ¹³				
Emërimi si prokurorë në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar		Vendime nr. 126-128, datë 19.05.2020		
Miratimi i aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës për periudhën Prill-Qershor 2020 ¹⁴		Vendim nr. 129, datë 19.05.2020		
Miratimi i Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit” ¹⁵			Vendim nr. 160, datë 08.07.2020	
Miratimi i fillimit të procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët për magjistratë prokurorë, të diplomuar nga SHM, në vitin akademik 2019 - 2020 ¹⁶			Vendim nr. 165, datë 15.07.2020	
Miratimi i hedhjes së shortit për caktimin e			Vendim nr. 166, datë 15.07.2020	

¹³ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-125-19.05.2020.pdf>

¹⁴ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/05/Vendim-nr-129-19.05.2020.pdf>

¹⁵ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/07/Vendim-nr-160-08.07.2020.pdf>

¹⁶ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/07/Vendim-nr-165-15.07.2020.pdf>

relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për magistratë prokurorë, të diplomuar nga SHM, në vitin akademik 2019 - 2020 ¹⁷				
Miratimi i fillimit të procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për programin e formimit fillestar të SHM, në vitin akademik 2020 - 2021 ¹⁸			Vendim nr. 167, datë 17.07.2020	
Miratimi i hedhjes së shortit për caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për programin e formimit fillestar të SHM, në vitin akademik 2020 - 2021 ¹⁹			Vendim nr. 168, datë 17.07.2020	
Emërimi i drejtorit të Byrosë			Vendim nr. 183, datë 30.07.2020	

¹⁷ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/07/Vendim-nr-166-15.07.2020.pdf>

¹⁸ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/07/Vendim-nr-167-17.07.2020.pdf>

¹⁹ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/07/Vendim-nr-168-17.07.2020.pdf>

Kombëtare të Hetimit ²⁰				
Zhvillimi i seancës dëgjimore mbi procedimin disiplinor nr. 251/31, datë 21.07.2020, ndaj magjistrate prokurore në Prok. pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ²¹			Vendim nr. 190, datë 17.09.2020	
Miratimi i rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” ²²			Vendim nr. 200, datë 23.09.2020	
Shpallja e vendeve të lira për kandidatët për prokurorë ²³			Vendim nr. 205, datë 30.09.2020	
Miratimi i relacioneve mbi verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të 2 kandidatëve për t’u emëruar			Vendime nr. 209-2010, datë 30.09.2020	

²⁰ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/08/Vendim-nr-183-30.07.2020.pdf>

²¹ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/09/Vendim-nr-190-17.09.2020.pdf>

²² <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/09/Vendim-nr-200-23.09.2020.pdf>

²³ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/09/Vendim-nr-205-30.09.2020.pdf>

magjistrat prokuror, pas diplomimit në SHM, në vitin akademik 2019- 2020 ²⁴				
Pezullimi i procedimit disiplinor në ngarkim të prokurores ²⁵				Vendim nr. 212, datë 6.10.2020
Miratimi i përlllogaritjes së mandatit të anëtarit të KLP ²⁶				Vendim nr. 213, datë 13.10.2020
Emërimi si prokurorë dhe caktimi në detyrë të 2 prokurorëve				Vendime nr. 2016-2017, datë 15.10.2020
Ngritja e Komisionit Ad- hoc për shqyrtimin e rasteve të qëndrimit publik të KLP në mbrojtje të figurës së prokurorit ²⁷				Vendim nr. 232, datë 27.10.2020
Miratimi i pjesëmarrjes së prokurorëve në aktivitetet trajnuese të SHM, për periudhën Tetor-Dhjetor 2020 ²⁸				Vendim nr. 233, datë 27.10.2020

²⁴ <https://klp.al/2020/09/30/vendime-date-30-09-2020/>

²⁵ <https://klp.al/2020/10/06/vendime-date-06-10-2020/>

²⁶ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/10/vendim-nr-213-klp.pdf>

²⁷ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/10/Vendim-nr-232-27.10.2020..pdf>

²⁸ <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/10/Vendim-nr-233-27.10.2020..pdf>

Miratimi i relacioneve mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatëve për t'u pranuar në programin e formimit fillestar të SHM, në vitin akademik 2020 - 2021 ²⁹				Vendime nr. 235-256, datë 27.10.2020
Trajnim mbi jurisprudencën e GjEDNj për çështjet disiplinore ndaj prokurorëve				Realizuar në dt. 02.10.2020
Miratimi i veprimtarisë jashtë funksionit të prokurorëve	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti
Caktimi në pozicion të përkohshëm të prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, si pasojë e largimeve nga procesi i vettingut	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti
Miratimi i raporteve për analizimin e veprimtarisë profesionale të prokurorëve, subjekte të rivlerësimit kalimtar	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti

²⁹ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendim-nr-235-27.10.2020..pdf>

Miratimi i mbarimit të statusit të magjistratëve prokurorë	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti
Miratimi i komandimit të magjistratëve prokurorë	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti	Rast pas rasti

Aktivitetet për t'u realizuar në tre-mujorin e fundit të vitit 2020

Emërtimi i aktivitetit	Janar-Mars	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Dhjetor
Hartimi dhe miratimi i rregullores mbi procedurat disiplinore të prokurorëve ³⁰	N/A	N/A	N/A	Vendim nr. 260, datë 17.11.2020, “Mbi funksionimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”
Hartimi dhe miratimi i rregullave për lëvizjen paralele të prokurorëve ³¹	N/A	N/A	N/A	Vendim nr. 261, datë 17.11.2020, “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”
Hartimi dhe miratimi i rregullores për vlerësimin e	N/A	N/A	N/A	Vendim nr. 27.10.2020, “Për miratimin e një ndryshimi

³⁰ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/11/Vendim-nr-260-17.11.2020.pdf>

³¹ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/11/Vendim-nr-261-17.11.2020.pdf>

veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve ³²				në Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”.
Zbatimi i rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” ³³	N/A	N/A	Vendim nr. 200, datë 23.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”	N/A
Shpallja e thirrjes për kandidatë të tjerë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme dhe emërimi i prokurorëve specialë për plotësimin e strukturës (në	N/A	N/A	N/A	Në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar

³² <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendim-nr-231-27.10.2020..pdf>

³³ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendim-nr-200-23.09.2020.pdf>

varësi të volumit të punës)				
Dhënia e opinionit në lidhje me riorganizimin e hartës gjyqësore	N/A	N/A	N/A	Në pritje të propozimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

IX. Plani i veprimit 2021-2024

Tabela e mëposhtme përshkruan planin e veprimit të planit strategjik 4-vjeçar. Plani 4 vjeçar i veprimit përbëhet nga pesë programe në drejtimet kryesore të punës ku vepron Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Secili nga programet përmban aktivitetet që planifikohen të realizohen në periudhën 2021-2024, nga komisionet e përhershme me mbështetjen e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë

2021-2024 Plani i Veprimit për KLP-në

Aktivitetet:	2021	2022	2023	2024
Programi 1: Administrimi i karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit				
1. Shpallja e thirrjes për kandidatë të tjerë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme dhe emërimi i prokurorëve për plotësimin e strukturës (në varësi të volumit të punës)	Emërimet sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)	Emërimet sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)	Emërimet sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)	Emërimet sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)
2. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullores me kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar të prokurorëve (Neni 24, pika 6, e ligjit për statusin)	Janar – Qershor (Hartimi dhe miratimi) Zbatimi	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi
3. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullores për pensionin e parakohshëm të prokurorëve (Neni 27, pika 4, e ligjit për statusin)	Prill – Shtator (Hartimi dhe miratimi)	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi

	Zbatimi			
4. Emërimi i kancelarëve i prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe i Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme	Zbatimi Emërimi sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)	Emërimi sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)	Emërimi sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)	Emërimi sipas kërkesës (në varësi me rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar)
Programi 2: Profesionalizmi dhe integriteti të garantuar nëpërmjet vlerësimeve periodike, standardeve etike dhe profesionale, këshillimit dhe monitorimit të trajnimit vazhdues				
1. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Rregullave (Kodit) për Etikën të prokurorëve (Neni 159/2/ç, i ligjit për qeverisjen)	Janar – Qershor (Hartimi dhe miratimi) Zbatimi	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi
2. Përgatitja dhe miratimi i programit të përvitshëm për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve	Janar – Mars	Janar – Mars	Janar – Mars	Janar – Mars

3. Këshillim i Shkollës së Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të prokurorëve, etj., (Nenet 186, 272/2, të ligjit për qeverisjen)	Çdo fillim viti akademik	Çdo fillim viti akademik	Çdo fillim viti akademik	Çdo fillim viti akademik
4. Verifikimi i pasurisë dhe i figurës së kandidatëve për t'u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për prokurorë dhe kandidatëve për ngritje në detyrë (pas krijimit të vakancave)	100 % e kandidatëve të verifikuar brenda afateve ligjore	100 % e kandidatëve të verifikuar brenda afateve ligjore	100 % e kandidatëve të verifikuar brenda afateve ligjore	100 % e kandidatëve të verifikuar brenda afateve ligjore
5. Mbështetje për KPK-në me raporte me cilësi të lartë për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar	Raporte të përfunduara për 90 % të shorteve të organizuar	Raporte të përfunduara për 90 % të shorteve të organizuar		
6. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë (Neni 72/4, i ligjit 97/2016)	Janar – Qershor (Hartimi dhe miratimi) Zbatimi	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi
7. Përgatitja e kurrikulës për formimin fillestar për kancelarin, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme (Neni 72/2, i ligjit 97/2016)	Prill – Shtator (Përgatitja e kurrikulës) Zbatimi	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi

8. Përgatitja e kurrikulës për formimin fillestar të nëpunësve të tjerë civilë në prokurori, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës (Neni 72/3, i ligjit 97/2016)	Prill – Shtator (Përgatitja e kurrikulës)			
Zbatimi	Zbatimi	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi
Programi 3: Përgjegjshmëria e prokurorëve e garantuar përmes sistemit disiplinor				
1. Raportimi periodik për llogaridhënien, zbatimin e procedurës dhe masat disiplinore	Periudha e raportimit Tetor – Dhjetor	Periudha e raportimit Tetor – Dhjetor	Periudha e raportimit Tetor – Dhjetor	Periudha e raportimit Tetor – Dhjetor
2. Emërimi i Këshilltarit për Etikën	Janar – Qershor		Trajnime vjetore	Trajnime vjetore
Ndërgjegjësimi i prokuroreve për përdorimin e instrumenteve që rrjedhin nga kodi i etikës, përfshirë edhe	Rishikimi i programit të trajnimit vazhdues për çështje të etikës, të Shkollës së Magjistraturës	Rishikimi i programit të trajnimit vazhdues për çështje të etikës, të Shkollës së Magjistraturës	<u>Objektivi:</u> 2-3 trajnime në vit në kuadër të programit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës	<u>Objektivi:</u> 2-3 trajnime në vit në kuadër të programit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës

	komunikimin e drejtpërdrejtë me Këshilltarin për Etikën			
3. Hartimi dhe miratimi i manualit informues për ndërveprimin e Këshilltarit për Etikën dhe prokurorëve, në trajtimin e dilemave etike	Janar – Qershor (Hartimi dhe miratimi) Zbatimi	Zbatimi	Shqyrtimi dhe zbatimi	Zbatimi
4. Konsultimi, njehsimi i praktikave dhe shkëmbimi i eksperiencave me Këshillin e Lartë Gjyqësor (krijimi i mekanizmave për shkëmbimin e eksperiencave)	Mbledhje vjetore <u>Objektivi:</u> 2 mbledhje të përbashkëta	Mbledhje vjetore <u>Objektivi:</u> 2 mbledhje të përbashkëta	Mbledhje vjetore <u>Objektivi:</u> 2 mbledhje të përbashkëta	Mbledhje vjetore <u>Objektivi:</u> 2 mbledhje të përbashkëta

5. Këshillimi i Shkollës së Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues për prokurorët në fushën e procedimit disiplinor; Analizimi i praktikës së GJEDNJ dhe të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me proceset gjyqësore për magistratët, për t'i përdorur përfundimet në trajnimet vazhduese në Shkollën e Magjistraturës	Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në kurrikulën e Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me të drejtat që gëzojnë magistratët në procesin disiplinor	Trajnime vjetore <u>Objektivi:</u> 2-3 trajnime në vit në kuadër të programit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës	Trajnime vjetore <u>Objektivi:</u> 2-3 trajnime në vit në kuadër të programit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës	Trajnime vjetore <u>Objektivi:</u> 2-3 trajnime në vit në kuadër të programit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës
Programi 4: Garantimi i pavarësisë së prokurorëve				
1. Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore për pavarësinë dhe mbrojtjen e prokurorëve, duke përfshirë lidhjen midis prokurorit dhe drejtuesit (përmes instrumenteve ligjore si, shqyrtimi i ankimeve të prokurorëve ndaj udhëzimeve të përgjithshme të PP apo drejtuesit të prokurorive, të ankimeve ndaj vendimit të	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit

drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, etj)				
2. Fuqizimi i pozicionit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për mbrojtjen e prokurorëve gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, përmes deklaratave publike apo veprimtarisë së Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve (neni 20/2, i ligjit për statusin dhe neni 185, i ligjit për qeverisjen)	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit	Rast pas rasti, sipas kërkesës/ankimit
Programi 5: Kontributi dhe opinionet për ndryshimin e legjislacionit				
1. Monitorimi dhe ndjekja e vazhdueshme e kuadrit ligjor për të identifikuar inkoherencat dhe mangësitë; formulimi dhe ndjekja e procesit të ndryshimeve ligjore	Monitorimi dhe ndjekja	Monitorimi dhe ndjekja	Monitorimi dhe ndjekja	Monitorimi dhe ndjekja

2. Shqyrtimi dhe bërja e rekomandimeve për ndryshime mbi funksionimin e rregullave të procedurës gjyqësore penale.

Rast pas rasti

Rast pas rasti

Rast pas rasti

Rast pas rasti

X. Vlerësimi i riskut

Tabela e mëposhtme përshkruan rreziqet e mundshme, përfshirë probabilitetin dhe ndikimin e mundshëm, që KLP parashikon në kryerjen e detyrave të tij, me masat lehtësuese përkatëse për shmangien apo uljen e efektit negativ që sjellin ato rreziqe.

Matricë e vlerësimit të riskut – KLP

Kuptimi i ngjyrës:	Pa ngjyrë Risk i ulët	Risk mesatar	Risk i lartë
---------------------------	----------------------------------	---------------------	---------------------

Përshkrimi i riskut	Parashikimi i nivelit të riskut	Ndikimi i mundshëm	Masa parandaluese/afati i propozuar për zbatim
I. Risqe të përgjithshme politike			
a) Ndryshime të ligjit			<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje aktive në procesin e ndryshimeve të ligjit, në varësi të ndryshimeve të propozuara
b) Mungesa e burimeve financiare			<ul style="list-style-type: none"> • Raportim shterues në Kuvend dhe i bazuar në të dhëna • Mundësi e lëvizjes së burimeve te pashpenzuara ne buxhet
II. Risqe të tjera të jashtme			
a) Rezultate të rivlerësimit kalimtar			<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për të rritur outputet prokurorëve të trajnuar për të siguruar

			<p>plotësimin e vendeve të lira</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm për marrjen e masave të përkohshme për të siguruar kryerjen e punës pavarësisht numrit të lartë të pozicioneve të lira në periudhën tranzitore
b) Koordinimi me Prokurorinë e Përgjithshme			<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i takimeve periodike ndërmjet Kryetarit të KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm dhe ndërmjet gjithë anëtarëve të Këshillit dhe Prokurorit të Përgjithshëm
c) Koordinimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor			<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i takimi periodike për koordinim dhe ndarje e eksperiencës ndërmjet Këshillave
d) Kapaciteti i Shkollës së Magjistraturës për trajnime – fillestare, të vazhdueshme			<ul style="list-style-type: none"> • Koordinimi midis donatorëve për trajnime mbi nevoja specifike
III. Rrisqe të brendshme			
a) Bashkëpunimi/koordinimi me stafin			<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i takimeve periodike me stafin
b) Rritje e kapacitetit të stafit (sasiore)			<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi paraprak i punës me ngarkesë të reduktuar
c) Marrëdhënia ndërmjet anëtarëve			<ul style="list-style-type: none"> • Dakordësimi i një kodi të brendshëm sjelljeje për marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të Këshillit

			<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i bashkëveprimit shoqëror ndërmjet anëtarëve të Këshillit në mënyrë të përsëritur
--	--	--	--

XI. Raportimi, indikatorët e performancës dhe sistemi i menaxhimit të performancës

Në lidhje me zhvillimin e planit strategjik, KLP përgatit edhe indikatorët e performancës, duke përfshirë vlerat bazë dhe mjetet e verifikimit.

Indikatorët e performancës dhe objektivat paraqiten në rubrikat që përmban plani i veprimit 2021-2024. Indikatorët kyç dhe objektivat e performancës paraqiten në tabelën më poshtë në Kapitullin XII.

Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit pranë KLP-së do të realizojnë planifikimin dhe monitorimin nën mbikëqyrjen e vet Këshillit.

Raport-progreset e përmbledhura tre-mujore do të përgatiten për ndjekjen e aktiviteteve të planit të veprimit duke filluar nga tre-mujori i fundit i vitit 2020 dhe në vazhdim.

Për sa i përket zbatimit të strategjisë, raportimi gjashtë-mujor i progresit planifikohet të sigurojë monitorimin në kohë të aktiviteteve dhe të mundësojë marrjen e masave të duhura, në rast se disa prej tyre janë mbrapa planifikimit/objektivave.

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit do të vendosë nëse dhe se si do të bëhet raportimi, ndaj këtyre treguesve dhe më pas do të vendosë nëse objektivat tremujor ose gjashtë-mujor si edhe raportimi do të përpunohen për disa indikatorë, dhe vetëm raportimi vjetor do të bëhet kundrejt objektivave të tjerë.

Në praktikë, një progres-raport tre-mujor përgatitet afërsisht një muaj pas përfundimit të tremujorit. Raportet e tremujorëve të parë dhe të dytë do të jenë të përmbledhur, ndërsa raporti i dytë tre-mujor do të përfshijë edhe një raport më të gjerë gjashtë-mujor duke trajtuar ndjekjen e indikatorëve të performancës së ndjekjes dhe planin më të gjerë të strategjisë. Ndërsa raporti i tre-mujorit të katërt, në të njëjtën kohë, do të jetë një progres-raport i përvitshëm, i cili tregon progresin në tre-mujorin e fundit të viti kundrejt një plani 12-mujor, si edhe ndjek indikatorët numerikë dhe objektivat më të gjerë të planit 4-vjeçar.

XII. Indikatorët Kyç dhe objektivat e performancës

Rezultati	Indikator	Baza	Objektivi 2021	Objektivi 2022	Objektivi 2023	Objektivi 2024	Mjetet e verifikimit
Administrimi i karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit	Indikator 1 % e prokurorëve të cilët besojnë se janë emëruar/rritur në detyrë jo sipas aftësisë dhe eksperiencës në dy vitet e fundit	Baza për t'u krijuar	Baza e krijuar	Për t'u krijuar	Për t'u krijuar	80 %	Anketimi vjetor i perceptimit
	Indikator 2 % e informacioneve për çështjet në lidhje me emërimin, transferimet, ngritjet në detyrë, gjendet online	0%	80 %	100%	100%	100 %	Faqja zyrtare e internetit

Rezultati	Indikatori	Baza	Objektivi 2021	Objektivi 2022	Objektivi 2023	Objektivi 2024	Mjetet e verifikimit
Profesionalizmi dhe integriteti të garantuar nëpërmjet vlerësimeve periodike, standardeve etike dhe profesionale, këshillimit dhe monitorimit të trajnimit vazhdues	Indikatori 3 - % e vlerësimeve, të cilat janë zbatuar brenda kohës së përcaktuar dhe sipas standardeve të dakordësuara	NA	80 %	95 %	100%	100%	Rekordet e administratës
Përgjegjshmëria e prokurorëve e garantuar përmes sistemit disiplinor	Indikatori 4 - % e çështjeve disiplinore të ngritura të cilat mund të ishin përfunduar brenda kohës së përcaktuar;	NA	60%	70%	80%	90%	Rekordet e administratës
	Indikatori 5	0%	80%	80%	80%	80%	Faqja zyrtare e internetit

Rezultati	Indikatori	Baza	Objektivi 2021	Objektivi 2022	Objektivi 2023	Objektivi 2024	Mjetet e verifikimit
	% e çështjeve disiplinore ndaj prokurorëve, në rastin kur informacionet përkatëse gjenden online;						
Garantimi i pavarësisë së prokurorëve	Indikatori 6 - % e prokurorëve, të cilët ndjejnë se janë të pavarur në vendimmarrjen e tyre	Për t'u krijuar	60%	70%	80%	90%	Anketimi i perceptimit ³⁴ midis prokurorëve

³⁴ Të përfshihet dhe përqindja e prokurorëve që kanë qenë subjekt i ndërhyrjes/influencës së faktorëve të jashtëm/anëtarëve të Këshillit.

XIII. Kuadri i Shpenzimeve Afatmesme të KLP-së

000mijë/lekë

Artikujt	PBA 2021- 2023		
	2021	2022	2023
Paga (600-601)	119 917,0	119 917,0	119 917,0
Korente të tjera (602-606)	41 000,0	41 000,0	41 000,0
Kapitale (230-232) të Brendshme	29 800	0,0	0,0
Kapitale (230-232) të Huaja	0,0	0,0	0,0
Jashtë-buxhetore			
Totali	190 717,0	160 917,0	160 917,0

Investimet e parashikuara për vitin 2021 janë si më poshtë:

- **Blerje autovetura për anëtarët e Këshillit (6 copë)** 19 000 mijë lekë
- **Blerje orendi zyre (kasaforta)** 800 mijë lekë
- **Ndarje funksionale dhe izolim i sallave të mbledhjeve** 7 000 mijë lekë
- **Arkiva digitale** 3 000 mije lekë